

RITUALE SHKULQIJE DHE MARTESJE NË SHOQËRINË TRADICIONALE ARBËRESHE

p. Emanuele Giordano

Ju tëfalënj juve, Arbëreshë o miq të Botës Arbëreshe, që ndodheni këtu o që keni organizuar këtë Festival të vjershit e të zakonevet popullore arbëreshe, o që keni dhënë e jipni kontributin tuaj ndër këto mbledhje të përbashkta. Kjo provon se Bota Arbëreshe jeton ende e se ka miq që duan se ka të mbijetonjë. Unë uronj se ky zgjim arbëresh të rronjë sa buka e vera!

Ky argument, që m'u dha mua, më pëlqen dhe e trajtonj me gëzim. Sepse unë e njoha Jetën Arbëreshe që prej së vogli. Kur pëstaj u rrita, i studhjoja zakonet që ishin edhe të gjalla ndër mes të popullit arbëresh. Studhjoja Rapsoditë e mbledhura ka De Rada, Dorsa, Bilotta, Santori, Argondizza, Camodeca etj.. Thom edhe se Bilotta la një dorëshkrim mbi Shkulqinë e mbi Martesën, që pjesërisht u botua mbi rivistën « Zëri i Arbëreshvet » (1972-1982). Rapsoditë Arbëreshe - që këndohshin Frasnitë dhe Ejaninë - më ngisjin zëmren e me entuzjazmojin, aq sa më të shumtit i regjistrova ka ata pak pjeq e pjaka që i dijin. Shumë motive Rapsodish i muzikova dhe i botova mbi « Zërin e Arbëreshvet », dhe sot janë të njohura dhe të kënduara ka Arbëreshë dhe Shqiptarë.

Martesa është një ngjarje sociale qendrore, shumë interesante, prandaj populli arbëresh mirr pjesë tek martesat me pëlqim.

Më parë (folmi për 70-80 vjet prap) martesa rrohej me më shumë intensitet: Me koreografi e me këndime që sot u buartin. Ndë katund rrojin edhe më shumë gjindje. Dhe gjindja ish më e thjeshtë e prit martesën si një festë. Sepse martesa ish një festë e madhe për gjith katundin. Ahiera s'ishin të tjera zbavitje (divertimenti).

Dita e Martesës ish dita më e bukur, për ata që vëjin kurorë : vërtetohej ëndrra e jetës së tyre. Dhe Bilota shkruan :

...Prandaj ahiera trimi thërritët dhëndërr,
se vasha atij nga natë i vete mb'ëndërr...
(Zakonet e Frasnitës, dorëshkrim)

Folmi nanë për Shkulqinë.

Kur prindët xëjin se i biri do të martohej, kërkojin të njihjin nusen : kuj e bila ish, ndëse ish e bukur dhe e mirë, e shëndoshtë, e pasur...; ndëse kish të tjera virtyte morale; ndëse i pëlqenij edhe gjirivet.

(Sot Shkulqitë bëhen edhe pa pëlqimin e prindëvet!)

Kur u dha pëlqimi i të gjithëve, prindët e dhëndrrit vejin e gjëjin, te shpia tyre, prindët e nuses : i qelljin ndryshe dhurata (lule, frute, furkën, boshtin...) edhe një thikëz për nusen. Pëstaj i qelljin edhe unazën.

Dhëndrri, me miqtë e tij, natën i këndonij nuses vjershe malli. Kur luajin ndër sheshet e katundit, dhëndrri luanij me nusen, pëstaj e lëj të luanij me miqtë e tij

Nusja i qepnij dhëndrrit një këmishë, i bjenij një skamandil dhe të tjera shërbise. Një muaj më parë se të vëjin kurorë, prindët e dhëndrrit i qelljin nuses vëthët, kanaka e të tjerë dhurtira; e ndërrojin, ndëse kish të veshura lipi (*zbardhjin nusen*) dhe e qelljin mbë qishë (*mbë të parë*).

Ndër të tjera dhurëti, dhëndrri – ditën më parë se të vëjin kurorë – i qellnij nuses *Kamizollën*. Për stolitë e tjera kish të kujdesej familja e nuses. Ndrejtin edhe shpinë ku kish të rrijin.

Pëstaj që u kishin shkruar përpara nutarit kapitullit e martesës e dokumentet qishtarë përpara priftit, nusja shtronij mbi shtratin e së jëmës stolitë e saja, se të ishin të para ka gjindjat.

Ashtu edhe dhëndrri, mbi shtratin e tij, shtronij stolitë e tija: tirq, xhipun, xhakëtë, këpucë, skolë, etj.... Atyre që i vizitojin i jipjin ëmbëlsira dhe akuavitë (*Uralat e nuses dhe të dhëndrrit*. Po edhe ata që vejin e i gjëjin, s'vejnin me duart e mbrazta: qelljin gjë dhurëti).

De Rada thot (shkruan se t'ënjtën më përpara se e diela e martesës, shpia e dhëndrrit mblohet më gjindë, e dy kore grash vënë ndë kufi si një vashëz gjeshën brumit për *petën*, që ka t'i jipet dhëndrrit. Këndojin kështu « *këngën e brumit* » :

*Se ti vashëz hadhjare,
që m'e gjeshën ata brumë,
gjeshe fort e ngure shumë...*

I thojin kështu sepse te tryesa e martesës dhëndrri e nusja kish të buthtojin fuqinë e tyre, kur t'e ndajin dy copash *petën*. Nusja, tek java parë se të vënij kurorë, bëftin finjën e banjin; gratë i lajin shirin me verë, ndërsa i këndojin :

*Ditë e bardhë shkepti ka mali,
dielli brinjavet m'u shtu
e dritësoi katundthin.
Prana qet e le hyri
te ku fjëj vasha e dëlirë...
e ndër ëndrra fjuturonij
se m'i qasej dita e lumtë
që vej nuse ajo zonjë...*

Një ditë më parë se të vëjin kurorë, kumbarët, mbrëmanet vejin e hajin te shpia e dhëndrrit mish dashi o shtjerri, tumac shpije me lëngë mishi e djathë. Ngapak shkrehjin, jasht, me tufiqet e tyre.

(Dorsa, tek « *Usi e credenze...* », f. 83, thot: « *Lo sposo è come un'aquila, che allora scende carica di neve dalle montagne, e si getta fra un nugolo di pemici...per afferrame una...* »).

Prindët e dhëndrrit ndrejtin shpinë ai kish të rrinij me nusen; dhe ndrejtin edhe mbrolat e tija.

Mbrëmanet më parë se të martohë, dhëndrri venej e i këndonij nuses, nën dritaren e shpisë saj :

*Moj ti luleza vjollë,
pripararme atë kamizollë,
se ti menatë ke t'vësh kurorë.
Menat dihet një ditë pullit
se vjen e t'merr ai mallthi it...*

(Ka t'pyhet ndëse ja hapjen dhëndrrit o jo...)

Kur dihej dita që kish të vejnin kurorë, kish shumë lëvizje ndër shtëpitë e dhëndrrit dhe të nuses..

Vejnin petën mbi një çistë të hapët (spazë), e mbulojin me një sqep gruaje (o një mësallë të hollë) të qindisur, ja vejnin mbi kryet e njëj gruaje e vejnin gjithë te shpia e dhëndrrit. Ture vatë, ngapak qëndrojnë e shkrehjin, se t'buthtojn se ishin po t'errëjin. I hapej dera dhe kumbisjin petën mbi shtratin.

Si qasej hera të vejnin mbë qishë, shtëpitë e dhëndrrit dhe e nuses mbjohshin me gjiri e miq: spëndohshin *uralat e nuses dhe të dhëndrrit*, ndërsa veshjin nusen e dhëndrrin.

Dhëndrrit i këndojn : kështu :

*Se ti trim, i lumi trim,
paç mbë hje ti, vëllathi im,
dha si dielli kur del,
si hëna kur perëndon...*
(Bil., Tesi Ag.)

I urojin edhe :

*Se ti trim e i lumi trim,
asaj udhje që të shkoç
aq lule nëmëroç...*
(Bil.)

Kur krehjin dhëndrrin, kështu këndojn :

*Se ti krëhër e krëhri im,
krehm'e mirë ti dhëndrrin :
se, mos m'e krehsh mirë
u dy çika me të bënj
e më të shtye pjëhravet...*
(Ag, f.229)

Te shpia e nuses, shoqëzitet e saja i këndojn :

*Paç mbë hje ti motra ime :
dha si dielli kur del,
si hëna kur perëndon,
si peta ndë mësallet,
si tariau ndë skamandilt*
(Bil.7, Ag.227-229)

*More vashëz hadhjare,
ndëse do të jesh hadhjare,
le zakonet e sat'emë
edhe mirr ata që gjën...*

Ndërsa këndohshin këta vjershe, jashtë shkrehjin.

Pëstaj mirrjin ka shpia e dhëndrrit stolitë e nuses, me këpucët, e ja qelljin asaj se t'i veshnij. Si errëjin kumbarët tek shpia e nuses, me stolitë e saja, ja jipjin e prirshin te shpia e dhëndrrit.

E pra nusja prit të vej dhëndrri t'e mirrë.

Si nusja kish mbaruar së veshuri e vënij kezën me sqepin (çë i mbulonij ballën dhe fytyrën), ulij mbi një thron.

E sho ezit e gjiritë i këndojn :

*Ulu, nuse, e lumja nuse,
t'erth hera çë vete nuse...*

*Vashë, ti spingull e rrëgjëndë,
pataksu e bjerë mbë këmbë :
mirr uraten e sat'ëmë
ndëse ti do të jeç hadhjare,
mirr liçenxë shokevet,
puthi dorën e t'yt et...*

Kur u kish ndrequr çdogjë ka dy shpitë, dhëndrri ngrëhej, puthnij dorën e prindëvet e me kumbarët, miqtë e gjiritë, venij tek shpia e nuses, se t'e mirrë.

Më parë korteu i burravet, pëstaj ai i gravet, i këndojn vjershe urimi. Ka dritaret miqtë shkrehjin mbë hare' e, ka shkonij dhëndrri, shillojin kulëndra, grurë, fasule, ris. *t'vrezë* - - - - -

Kumbarët, jashtë, kështu i këndojn dhëndrrit :

*Se ti zot e dhëndrrith,
mos m'ec ti i trëmburith,
se ti s'vete të luftosh,
po ti vete të rrëmbesh
atë kryemollëzën,
atë mes-purtekëzën...*

Kur korteu i dhëndrrit errënij te shpia e nuses, pas një të shkrehuri, kumbarët e shokët e dhëndrrit shtyjin derën e shpisë së nuses dhe e hapjin; hyjin mbrënda, mirrjin për dorje nusen dhe e ngrëjin

I vjehri ftonij (mbitonij) nusen t'venij mbë qishë.

Gratë mbrënda këndojn, në vend të nuses :

*Dil, e lumja ti mëmë,
dil e shih petritin tënd...*

Kori i burravet, për dhëndrrin, këndojn jashtë :

*Vjen petrit e strapetrit,
vjen të bjerë e s'ka ku t'bjerë,
bie ndë derët e së vjehrrës...*

Dy koret, mbrënda e jashtë, këndojn :

*Ndallandyshe xerkë-bardhë,
hape shpejt e m'u buthto
se t'erru jari mbë derë...
(jari(lo sposo), da Ares-marte, i ari?)*

H

Kori i nuses këndonij

*Çë t'bëra, ti mëma ime,
e më nxore ka gjiritë
ka gjiritë e vatrës sate?*

Këtu i jati i nuses, me skamandilin ndër duar, i thonij dhëndrrit :

-Ti ç'do? Do nusen o skamandilin?

Dhëndrri : *Dua nusen.*

I jati nuses : *Za, mirr skamandilin, se nusja të vjen pas.*

Pra i jati dhëndrrit i thonij nuses :

*Ngreu, nuse e ulu nuse,
se t'erth hera ç'vete nuse
(e e ngrëni)*

Gjandjat nisëshin të vejnin mbë qishë.

Më parë vinij dhëndrri me prindët e tij, për krei korteut të burravet.

Korteu i nuses, me shpezit e gratë, i venij pas. Ngapak shkrehjin. Përpara gjithëve venij nusja (e mbaritur për dorje ka dy djem : . Ajo ecnij me kryet ulur, me sqepin mbi krye e mbi ballët; tek dora kish një skamandil të bardhë mëndafshi të qindisur e me figura të ndryshme.

Këndojin koret, ture ecur.

Dhëndrrit :

*Se ti trim e i lumi trim,
asaj udhje çë të shkoç,
aq lule nëmëroç...*

Nuses :

*Paç ^{më} hje, ti motra ime,
dha si dielli kur del,
si hëna kur perëndon...*

Të dyve :

*Hapu mal e bënu udhë
të më shkonjë këjo thëllëzë;
Hapu, mal, e bënu udhë
se ka të shkonjë ky petrit...*

Ndërkaq errëjin mbë qishë.

Përpara derës i pret prifti dhe pyen dhëndrrin e nusen (me kumbarët mbanë) ndëse duhen e ndëse duan të martohen. Pëstaj i kallën mbë qishë e i këndon :

*Eja ti nuse e mirë e e dëlirë,
eja, ti dhëndërr i butë e hajdhjarë :
mirrni bekim të Perëndisë
edhe të shën Mërisë e të shëjtravet.
Pra hapni fëmilë mbë paqë e me shëndetë.*

5

Prifti bën shërbesën e martesës.

Kur i ndërrojën unazat, kumbarët thonë :

*Këto unaza ju i vu ky zot,
mirrni vesh çdo ju thot :
ndë sot firmën ju e vëni,
menatë s'kini më çë t'bëni
ose :*

*Gjegjini çë ju thot kumbari :
j'u ngjit rrodhëza te kulari;
shihni ju si kin' t'amari,
e këtu e nj'qin vjet ju kin'skuqari!*

Kur kumbarët i ndërrojën kurorat, i thonë :

*Rrofshi, gëzofshi, bil e bila shtofshi
e kurrë më u martofshi!
ose*

*Këto kurorë ç'ju vë mbi krye
Ju i bekoftë ajo Shën Mërie,
Shën Mëria e Zoti Krisht :
të parin bir e bëfshit prift!*

Si mbarohej Martesa mbë qishë, dhëndrri e nusja, me kumbarët mbanë e me kortenë e tyre, diljin ka qisha e gjindja i venij pas njera te shpia e dhëndrrit. Gjatë udhës, zëjin njetër herë këndimet :

*Hapu, ma!, e bënu udhë
të më shkonjë këjo thëllëzë.
Hapu, ma!, e bënu udhë,
të më shkonjë ky petrit...*

Si errëjin te shpia e dhëndrrit, s'këndoijn më.

Përpara derës, çë i hapej, dhëndrri prit pak të vinij nusja. Si kjo mënonij, dhëndrri sulej si t'ja rrëmbenij prindvet ose vëllezërvet. E rrëmbenij dhe ngatërrenij gjishtin e vogël të dorës së tij me të sājnin, dhe e tëhilq mbrënda ndë shpi me 'të.

Përpara derës, gjëjin të jatin o të jëmën e dhëndrrit, çë i rrëmbenij të dy për xerku me një skamandil mëndafshi të shtrëjtë, i kallnij mbrënda e pëstaj i jip qyçet e shpisë së re.

Gjindja hynij mbrënda dhe i jip atyre urime, ture i kënduar kështu :

*More nuseza hajdhjare,
ti ndë do të jeç hajdhjare,
kij pjotë golën me mëmë,
kij pjotë golën me kunat...*

Këtu, i jati, o gjiritë e dhëndrrit, i jipjin uralat gjindjes, mbrënda e jashtë.

Kur mbarojn urimet, dhëndrri mirr.nusen për dorje, e qellnij afër shtratit të tij, ulej pak me nusen mbanë, i ngrënij sqepin ka ballët dhe e ruani me mall.

Si diljin gjindja e miket e nuses, mbrënda zëjin valle me nusen; e i këndoijn asaj vjershe urimi :

Se ti nuseza hajdhjare,
çë do bëfsh të pastë hje.
Paç uratën, motra jonë,
si të t'Ynzoti edhe tonën...

Ndërkaq, e jëma e dhëndrrit nxir ka kusitë rrashkatjelltë me mishtë e dashit o të shtjerrit e i qellnij mbë tryes; pra ftonij gjithë të ulshin mbë tryes : më parë nusen, ç'rrij si e përtuçme; pëstaj dhëndrrin, kumbarët e gjiritë. E gjithë hajin e pijin. Vet nusja sapo i shijonij të ngrënat çë i jip e vjehrra, e nëng hanij, sikur të kish turpë. Hanij më pëstaj, kur gjithë kishin mbaruar së ngrëni. Kur hajin, ngapak shkruhej jashtë. Mbrënda bëjin shamat (zhurmë :), qeshjin... E ture ngrënë këndojin « vjershin e trieses » :

Kush m'e jëndi tryesën?
M'e jëndi buka e vera,
rrushi e kuq e mollvoziu...

E mbajin mendë edhe të ngrënit e Skanderbekut :

Ç'ish të ngrënëthit e tij?
Mish shtjerrit e lepurish,
me krera thëllëzazish...

Kur mbarojin së ngrëni, dhëndrri e nusja çajin *Petën*. Dhëndrri e hilq ka nj'anë e i jip jetrën anë nuses. Pjesa më e madhe i ngit nuses, çë ja ndanij mikevet të saja. Dhëndrri ja ndanij shokëvet të tij. Jashtë shkrehjin, mbë haré.

Pëstaj gjithë ngrëhshin ka tryesa e jashtë zëjin vallet me karramunxa, tumbarina e arganët. Më parë luajin nusja e dhëndrri, pra gjiritë e shokët

Te kjo valle këndohej Rapsodia, çë De Rada thot se e gjegj « ka një grua përçilote » (ex *Poetica ogji Ejanina*):

Kur leve ti vashë,
un te dera jote jesh :
lutja e parkalesja
të më lehshe një syzezë.

*Prita pax e prita shumë
e syzezë vasha nu'u le.*

Një të dielltëz menatë
U m'u nisa e vajta vet
E m'e gjeta (çova) ndë kamaret
Ç'ish e pjeksnej këshen e saj.

*Kësheti ish një villostar
çë pjeksnej me filozor.*

Pika lot i bijin ndë gji
Po ato s'ishin pika lot,
se ish zjarmi i të dashurit.
E tēfala e i ndējta dorën;
vithe kalit pra m'e vura
e m'u shtura sheshevet...

Po i vëllai nuses e prit tek urëza e lumit, se t'e vrit :

..... Ndënji e priti ai nd'amahj

tek urëza e lumit...

Atje ranë tre o katër.

Pra kollarti ai ka kali

Me pas të bukurën.

Atjë i pushtuan gurë...

I vëllai nuses, me katër ungjël e shtatë kushërinj, pritëtin dhëndrrin e nusen tek urëza e lumit ku kish t'ish hoxhin. Atje u luftua. Ranë tre o katër, po pëstaj ranë edhe dhëndërrin e nuses, e gënjë, mbuluar me gurë. - Rapsodia vashkon:

"Kur lulëzoi vera - trimi u bë një qeparis - vasha u bë një shiri e bardhë
e u krumbis te qeparisi... - ato delirëshin. shkojin të sëmururit -
hojin e shërohëshin - shkojin të lavorurit - bëjin sjetë qeparisi
e ato delirëshin. -

→ Kjo është një Rapsodi që folën për vjedhjen e nuses ka ana e dhëndrrit kundër vëlimesë prindëvet dhe të vëllaut. Kjo vjedhje mbaroi lik, sepse vëllau e gjiritë e nuses, bënur si kur kish t'i jipjin palën nuses, i vranë. (1)

→ Herët, shumë martesë bëheshin me vjedhjen e nuses. Gjurma e kësaj vjedhje është të shkrehurit në të vënit kurorë. (2)

Kur sosnij (mbaronij) së kënduari ajo valle, sosnij edhe festa e martesës.

VB (1) Kjo Rapsodi na thot se kur malli (dashuria) e të mirave është e fortë dhe e sigurtë, s'na që të bëjmë mesazjeri, - sepse ajo ia shuri natyrore qëndron edhe pas vdekjes.

(1) De Rada nota: Bella de prammode è questa creazione: La figura incantevole allagierata, etc., mentre incassate s'erua e intruccia i capelli per la morte, ricordando lagime spontanea da ignota fonte; e poi il cipresso e la vite che gli si appoggia, mate ia su le Sabine amanti, elevate su nel ciclo pre-fante a figurare. (Memorie la prima parte e con facienti garaggin. in terra d'Arone con quattro come modo figurare di altre sentenze. in 20 re. in 1800. (Raps. nazionali. libro I. Raps. XVIII p. 12-13).